



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

LISTA E ÇMIMEVE TË PRODUKTEVE DHE SHËRBIMEVE FINANCIARE

Informata të përgjithshme

Për të marrë vendime të duhura kur bëjmë blerje, ne krahasojmë ofertat në treg: përparësitë dhe anët negative të produktit. Njëjtë duhet të veprojmë edhe kur blejmë produkte apo shërbime financiare. Sikurse në shumicën e vendeve të botës, edhe në Kosovë, bankat/institucionet kredidhënëse operojnë bazuar në ekonominë e tregut të lirë. Megjithatë Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK), e rregullon me legjislacion përkatës secilën fushë dhe i mbikëqyr nga afër se a janë duke e zbatuar këtë legjislacion. Për t'i informuar konsumatorët lidhur me çmimet e produkteve dhe shërbimeve, institucionet financiare në bazë të udhëzimeve të BQK-së, obligohen t'i publikojnë çmimoret e produkteve dhe shërbimeve financiare. Të gjitha bankat (institucionet kredidhënëse) janë të obliguara të publikojnë listën e çmimeve të të gjitha tarifave për të gjitha produktet dhe shërbimet që ato ofrojnë dhe që të sigurohen që çdo degë dhe njësi e tyre mbanë në çdo kohë listat e tilla të çmimeve të printuara, si dhe t'i publikojë edhe në faqen zyrtare të bankës.

Shikoni me kujdes dhe krahasoni listën e çmimeve dhe të gjitha tarifat e produkteve dhe shërbimeve që ofrojnë bankat e që operojnë në Kosovë.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

www.bqk-kos.org


Çka është Lista e çmimeve?

Lista e çmimeve përmban informata të qarta dhe të kuptueshme mbi kushtet e përgjithshme të produkteve dhe të shërbimeve financiare, të cilat janë në dispozicion për publikun dhe kryesisht janë:



Të kategorizuara

Bankat zakonisht shpalosin dy lista të shërbimeve dhe produkteve për klientë privat/individual dhe për biznese, në mënyrë që klientët të kenë mundësi të bëjnë krahasimin e listave të çmimeve të bankave të ndryshme;



Të përditësuara

Bankat duhet të sigurohen që listat e çmimeve të përditësohen rregullisht dhe nuk duhet të imponojnë tarifa të cilat janë më të larta se struktura e shpalosur e tyre ose të llogaritin tarifatat e tyre në kundërshtim me kriteret e shpalosura të llogaritjes.



Lehtë të qasshme

Bankat duhet të sigurohen që çdo degë dhe njësi e tyre që merret me shërbimin e klientëve të mbajë në çdo kohë listat e çmimeve të printuara, të cilat përmbajnë informacionin e nevojshëm për klientin. Informacioni i tillë duhet të jetë i qartë dhe i kuptueshëm, e po ashtu duhet të jetë i publikuar edhe në faqen zyrtare të bankës.

Lista e çmimeve zakonisht përmbanë tarifën apo ndalesat për të gjitha produktet dhe shërbimet, të cilat i ofron institucioni kredithënës / banka.
Në vijim gjeni disa prej tyre:

→	Tarifa për hapje të llogarisë
→	Tarifa për mirëmbajtje të llogarisë
→	Tarifa për tërheqje apo deponim të mjeteve financiare
→	Tarifa për kartela bankare
→	Tarifat për pagesa dhe transfere të mjeteve financiare
→	Normat e interesit për kredi
→	Normat e interesit për depozita
→	Si dhe çmimet (tarifat) për përdorimin e produkteve dhe shërbime tjera financiare

Nëse lista e çmimeve nuk ju bëhet e ditur nga ana e personelit bankar ju duhet të kërkoni që t'ua shpalosin atë.

Normat e interesit për kredi dhe depozita

Bankat janë të obliguara që të shpalosin në mënyrë transparente tarifatat për shërbimet e ofruara. Para përzgjedhjes së produktit apo shërbimit dhe para lidhjes së kontratës, bankat duhet të sigurojnë informacionin komplet për klientin, lidhur me kushtet, afatet, normën e interesit dhe normën efektive të interesit si dhe tarifatat tjera.

Ky informacion duhet të sigurohet në formë të shkruar për klientin dhe para nënshkrimit të kontratës.

Norma e interesit shprehet si përqindje fikse apo e ndryshueshme, e aplikuar në bazë vjetore në shumën e aprovuar të kredisë apo në shumën e depozitës së pranuar nga banka. Norma Efektive e Interesit - NEI nënkupton koston totale të kredisë ose kthimin e depozitës, të paraqitur si normë vjetore e vlerës totale të kredisë ose kthimit total nga depozita. Gjatë llogaritjes së NEI, kostoja totale e kredisë nuk do të përfshijë shpenzimet e klientit ndaj palëve të tjera (për shembull: noteri publik, autoriteti i taksave, regjistri i hipotekave) përgjatë përpilimit të marrëveshjes së kredisë dhe çdo shpenzim tjetër për regjistrim dhe garanci. Megjithatë, të gjitha këto shpenzime duhet të shpalosen me shkrim dhe në formë të qartë për klientin para realizimit të kontratës.

Kostoja totale e kredisë për klientin nënkupton të gjitha kostot, përfshirë interesin, komisionet, taksat dhe çdo lloj tjetër të shpenzimeve që banka i kërkon klientit t'i paguajë, në lidhje me marrëveshjen / kontratën e kredisë.



Edukimi
Financiar

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës përmes Programit për edukim financiar ka për qëllim ngritjen e nivelit të njohurive financiare të qytetarëve për marrjen e vendimeve të duhura lidhur me produktet dhe shërbimet financiare.

BQK, synon që të kontribuojë në mirëqenien financiare të publikut duke nxitur dhe ruajtur një sistem financiar stabil në vend.

Kontakti:

Departamenti për Marrëdhënie me Jashtë

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Adresa: Rr. Garibaldi Nr. 33 Prishtinë, Kosovë

e-mail: edukimi@bqk-kos.org